



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 497 prot.

Fushë-Arrëz, më 18 . 02 . 2025

NJOFTIM

PËR MBLEDHJE TË KËSHILLIT TË BASHKISË DHE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz:

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, si dhe Rregullores për funksionimin e Këshillit të Bashkisë, në bazë të mbledhjes së Kryesisë së Këshillit të datës 12. 02. 2025, njoftoheni se mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë për muajin Shkurt 2025 zhvillohet, **ditën e Premte, datë 28.02.2025, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak** me rend dite:

1. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % për muajin Janar 2025.
2. Raport monitorimi i buxhetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën Shtator-Dhjetor 2024 (progresiv).
3. Projektvendim për miratimin e propozimit për dhënie titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Fushë-Arrëz të Z. Ndoc Prendi.
4. Raport vjetor i veprimtarisë dhe vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, për periudhën Janar-Dhjetor 2024
5. Rishqyrtimi i vendimeve të kthyer nga Prefektura.
6. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
7. Të ndryshme.

MBLEDHJE TË KOMISIONEVE

- Mbledhja e Komisionit të Mirëqenjes Sociale, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut (**Franc Doda ,Tereze Dema, Pavlin Qafa**), ditën e **Mërkurë**, datë **26. 02. 2025, ora 10:00** në sallën e mbledhjeve të këshillit për **pikën 1** të rendit të ditës.
- Mbledhja e Komisionit Këshillimor për shqyrtimin e propozimit për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Bashkisë Fushë-Arrëz, Z. Ndoc Prendi (**Gjevalin Alija; Pashk Prenga; Mustaf Pashkaj; Besjana Marku; Zef Cara**), ditën e **Mërkurë**, datë **26. 02. 2025, ora 11:00** në sallën e mbledhjeve të këshillit për **pikën 3** të rendit të ditës.

Duke ju falenderuar, njëkohësisht kërkoj korrektësinë tuaj për pjesëmarrje në mbledhjet e komisioneve dhe mbledhjen plenare të Këshillit të Bashkisë!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al